



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE TRAJNIMIT

PROGRAMET E KURRIKULËS BËRTHAMË TË GJIMNAZIT

FUSHA: ARTE

LËNDA: KËRCIM

KODI: 1.2

PROGRAMET E LËNDËS KËRCIM PËR KLASAT 10-12

TIRANË, SHTATOR 2008

Zhvillimi i lëndës së kërcimit për herë të parë në gjimnaz, kërkon që ta pajisë nxënësin me shprehitë, gjuhën e larmishme të lëvizjes së ngritur në art, si dhe studimin e përvetësimit e trajtave plastike të trupit që reagon sipas përcaktimeve artistike në sensin teorik e praktik.

Lënda e njeh nxënësin me zhvillimin e gjatë historik që ka ndjekur kërcimi, por edhe e prezanton me *elementet estetikë*, si mjet për të kuptuar të bukurën në këtë lloj arti, duke krijuar nocionet e qëndrueshme mbi përmbajtjen në përgjithësi, si dhe në kërcim në veçanti, duke u mundësuar nxënësve të njohin, praktikojnë, realizojnë kërcime të thjeshta në shkollë.

Në mënyrë të veçantë, kërcimi si një art që zhvillohet në grup, do t'u japë mundësinë të rinjve të edukohen me frymën e respektit reciprok për njëri-tjetrin, të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit përmes një komunikimi artistik, qytetar dhe të drejtë, ku do të mund të kultivohen cilësi të tilla si lirshmëria, aftësia për të kërcyer, si dhe guximi për t'u shprehur përmes kërcimit në mjedise të ndryshme.

Zhvillimi i kësaj lënde kërkon që përmes studimit të saj të arrihet përvetësimi i kërkesave bazë të lëndës, duke dhënë kontribut të ndjeshëm në *zhvillimin personal* të nxënësve, duke u dhënë mundësinë atyre që ta shohin veten si pjesë e shoqërisë dhe pjesëmarrës aktivë në të.

Kjo lëndë ndikon harmonishëm edhe në *përgatitjen artistike të nxënësve, si qytetarë aktivë të një shoqërie evropiane.*

1. SYNIMI I LËNDËS

Ky program synon:

të ndihmojë në formimin kulturor të nxënësve, duke i orientuar ata drejt kuptimit dhe krijimit të bukurës e harmonisë në kërcim, njohjes dhe zhvillimit historik të kërcimit në kontekste dhe kultura të ndryshme. Duke marrë pjesë në procese konkrete realizimi, nxënësve do t'u jepet mundësia për të zhvilluar aftësitë dhe shijet e shprehjes së tyre artistike. Kërcimi u jep mundësinë e formimit të një trupi harmonik dhe të rregullt në moshën e adoleshencës, duke shfaqur ndikim të fuqishëm në përcaktimin e etapave të mëtejshme zhvillimore, fizike, individuale të njeriut.

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHME

Në përfundim të këtij programi nxënës/i, - ja:

- të përdorë elementet estetikë si mjet për të interpretuar të bukurën në kërcim;
- të realizojë koordinimin dhe komunikimin partnerial vajzë – djalë gjatë kërcimeve;
- të improvizojë performanca të caktuara artistike në funksion të mendimit, si: poza skulpturale, pantomima, improvizimi;
- të analizojë zhvillimin e historisë së kërcimit dhe kërcime të ndryshme në periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore - historike;

- të shikojë kërcimin si mjet për të zhvilluar karrierën e tyre në të ardhmen.

3. OBJEKTIVA SIPAS LINJAVE

54 javë x 1 orë = 54 orë

Linja 1: Estetika e arteve dhe kërcimi¹

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë njeh nxënësit me disa ligje të përgjithshme të estetikës, që karakterizojnë artin në përgjithësi dhe krijimtarinë artistike në veçanti. Nxënësit njihen me objektin e artit, kategoritë estetike, klasifikimin e arteve në muzikë, art pamor, kërcim dhe teatër, si dhe lidhjen e tyre me njëri-tjetrin. Këto ligje të përgjithshme të artit dhe veçoritë e tij në raport me veprimtari të tjera të njeriut dhe shoqërisë, shërbejnë si urë për të kaluar në njohjen e secilit lloj arti në veçanti. Nxënësit zotëron një terminologji shprehëse për të gjitha format e kërcimit dhe do të përshkruajnë drejt, raportet e lidhjet organike të këtij lloji arti dhe raportet e saj me muzikën dhe artet e tjera.

Orët e sugjeruara²: 5

Linja	Objektiva
Estetika e arteve dhe kërcimi	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë artet si pjesë e objektit të <i>estetikës</i>; • të dallojë konkretisht <i>cilësitë estetike</i> në një vepër arti (muzikë, teatër, art pamor dhe kërcim); • të klasifikojë artet: muzikë, art pamor, kërcim dhe teatër, sipas <i>mjeteve të tyre shprehëse</i>; • të përshkruajë dallimin midis <i>arteve të thjeshta</i> dhe <i>arteve të përbëra</i>; • të përshkruajë <i>lidhjet e llojeve të ndryshme të arteve me njëri-tjetrin</i>;

1. Estetika do të zhvillohet nga përdoruesit e programit (mësuesit dhe autorët e teksteve si një linjë e përbashkët, *nëse do të jetë një tekst për të katër lëndët*, pasi edhe çështjet e vendosura si kërkesë për studim janë të njëjta, duke veçuar vetëm klasifikimin e arteve sipas mjeteve të tyre shprehëse). Orët e estetikës, pikërisht në objektivat me përmbajtje të përbashkët, realizohen në mënyrë të përbashkët për të dyja lëndët. Edhe objektivat që lidhen specifikisht me lëndën e zgjedhur do të shpjegohen dhe realizohen në mënyrë të përbashkët për të dyja lëndët. Orët e mbledhura për të dyja lëndët e përzgjedhura janë 10 orë, nga të cilat 4 orë mund të përdoren për shpjegimin e kuptimit të përgjithshëm të estetikës për të gjitha artet dhe 6 orët e mbetura mund të planifikohen sipas specifikave estetike të lëndës së përzgjedhur (3+3).

² Orët e sugjeruara janë orët e planifikuara nga specialistët për zhvillimin e linjës. Shuma totale e orëve të linjave duhet të jetë sa numri i plotë i orëve në planin mësimor për këtë lëndë. Quhen të sugjeruara sepse i jepet liri zbatuesit të programit (mësuesit) që të shtojë, ose të pakësojë numrin e sugjeruar të orëve në masën 10.% sipas nevojave të klasës.

	<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë <i>ndryshimin</i> e shijeve estetike në kërcim, duke u nisur nga krahasimi i dy veprave të periudhave të ndryshme; • të argumentojë parapëlqimet e veta në grup, familje etj., (si p.sh.: një balet i periudhës së Romantizmit apo një balet i shek. të 20-të); • të shkruajë një ese ose artikull kritik mbi vlerat estetike të një zhanri të caktuar koreografik, të një periudhe të caktuar; • të shpjegojë rrugët përmes të cilave, duhet të orientohet për të parë një shfaqje artistike, si p.sh: <i>llojin e shfaqjes, ku dhe kur</i> zhvillohet, <i>rregullat</i> para, gjatë dhe pas shfaqjes etj.
--	---

Linja 2: Elementet dhe parimet e kërcimit

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë mundëson njohjen e nxënësve me elementet dhe parimet në kërcim të cilat janë *hapësira, koha, energjia dhe forma, hapat, figurat e fiksuara, pantomima, plastika e trupit, gjestet e duarve dhe shoqërimi muzikor*.

Ata do t'i përdorin ato për të identifikuar dhe përshkruar kërcime nga zhanre të ndryshme kërcimi, si dhe do të mbajnë qëndrim ndaj *përmbajtjes* së një vepre skenike - koreografike, duke përdorur një terminologji specifike në këtë lëndë.

Orët e sugjeruara: 4

Linja	Objektiva
Elementet dhe parimet e kërcimit	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të identifikojë <i>elementet kryesore</i> që përbëjnë tërësinë e një përvoje skenike – koreografike; • të shpjegojë <i>elementet</i> që përbëjnë një vepër koreografike, si p.sh: <i>libretin</i> si një vepër letrare që përmban veprimin dramaturgjik të koreografisë dhe që është pikënisja kryesore ku frymëzohet kompozitori për krijimin e muzikës; • të njohë <i>monologun</i> si mjet për të shprehur forcën artistike dhe psikologjike, emocione të ndryshme dhe mendimin e kërcimtarit në një shfaqje; • të përshkruajë rolin kyç që luajnë: a) <i>balet maester</i> (ose koreografi/ja) b) <i>dramaturgu/ja</i>, c) <i>regjisori/rja</i>, në ndërtimin e një vepre koreografike; • të njihet me figurën dhe rolin e rëndësishëm të <i>koreopetitorit</i> si person i dytë artistik, pas balet maestrit/es. • të kuptojë rolin e <i>korifeut</i>, i cili udhëheq vallen në një

	<p>trupë kërcimi;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë <i>lëvizjet trupore</i> si elemente kyçe për realizimin e një kërcimi të caktuar; • të përshkruajë <i>efektin emocional</i> që ndodh midis <i>kërcimtarit/es</i> dhe <i>spektatorit</i>; • të kuptojë pse <i>ndryshimet trupore të njeriut</i>, çojnë në realizimin me sukses ose jo të një kërcimi.
--	---

Linja 3: Procese të realizimit të kërcimit

Përshkrimi i linjës: Në këtë linjë nxënësit kuptojnë se të gjitha elementet dhe parimet e mësuara më sipër, gjejnë zbatim në procesin krijues dhe realizohen duke performuar. Ata do të realizojnë përmes motivit dhe lëvizjeve bazë *etyde* dhe *ushtrime përgatitore*, apo *pantomimën* si arti i cili shprehet nëpërmjet plastikës së trupit dhe shprehjes së fytyrës. Njohja me *monologun* do të shërbejë për të zhvilluar aftësitë e shprehjes koreografike dhe aktoriale si një nga elementet shprehës skenikë, që shërben për zberthimin e ngjarjes, të mendimit dhe të emocionit.

Orët e sugjeruara: 24

Linja	Objektiva
Procese të krijimit & realizimit skenik	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të zhvillojë <i>aftësitë kërcyese</i>, duke improvizuar lirshëm para klasës së improvizuar si publik (<i>kërcim i lirë</i>); • të realizojë lëvizjen bazë të një kërcimi të caktuar; • të përdorë <i>lëvizjet bazë me figura të thjeshta</i> dhe <i>pozicionet kryesore</i> për të realizimin e një kërcimi të caktuar; • të përdorë <i>hapat, kërcimet dhe vrapin</i> për kombinime krijuese në një kërcim; • të zhvillojë <i>pantomimën</i> si një gjini e artit teatral, ku përmbajtja jepet nëpërmjet <i>mimikës, gjestit, lëvizjes plastike</i> dhe <i>pozës</i>; • të shfrytëzojë <i>elementet dhe intonacionet muzikore popullore</i> për realizimin e kërcimeve popullore, të cilat mbështeten në psikologjinë kombëtare të vendit, duke realizuar kombinime artistike në bazë të një ideje qëndrore.

Linja 4: Historia e kërcimit, bota dhe shoqëria

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë i përgatit nxënësit me njohuri të përgjithshme të zhvillimit të kërcimit në periudha të ndryshme historike, sipas zhvillimeve përkatëse shoqërore, duke paraqitur karakteristikat e veçanta të përfaqësimit kulturor dhe duke nënvizuar gjithashtu edhe çështjet që ndërthuren me aspektin estetik, për të edukuar nxënësit me shijen e së bukurës. Kjo linjë kërkon të zgjerojë njohuritë dhe formimin kulturor të nxënësve, duke i aftësuar ata për t'iu përgjigjur emocionalisht kërcimeve nga zhanre të ndryshme, atij modern (duke përfshirë këtu disiplinat e ndryshme që njeh kërcimi i sotëm), por duke mos harruar edhe rëndësinë që ka kërcimi në kulturën tonë autentike kombëtare, e cila do të trajtohet me shumë vëmendje.

Orët e sugjeruara: 17

Linja	Objektiva
Historia e kërcimit, bota dhe shoqëria	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none">• të klasifikojë analizojë zhvillimet e kërcimit në shoqërinë njerëzore në periudha të ndryshme historike prej artit parahistorik e deri në ditët e sotme, duke u mbështetur në karakteristikat specifike, historike, stilistike dhe estetike të kërcimeve të ndryshme;• të përdorë kërkimet, krahasimet, diskutimet dhe debatin, rreth zhvillimit të kërcimit dhe krijimit të veprave koreografike, me përfaqësues kryesorë shqiptarë apo të huaj:<ul style="list-style-type: none">- <i>Arti parahistorik</i> -fillimet e kërcimit në shoqërinë njerëzore <i>karakteristikat e veçanta</i>.- <i>Kultura e orientit të largët</i> (Indi).- <i>Kërcimi në periudhën e Antikitetit klasik</i> dhe zhvillimi i kërcimit gjatë zhvillimit të qytetërimeve të ndryshme <i>Greke dhe Romake</i>:<ul style="list-style-type: none">- vallet arkaike greke,- vallet e epokës së qytet shteteve, shek VI –V p.e.s.,- vallet e epokës helenistike, shek IV – II p.e.s.- <i>Lindja e baletit si gjini</i> - zhvillimi i kërcimit gjatë mesjetës.- Periudha e Rilindjes dhe zhvillimi i baletit. <i>Zhvillimi i gavotës, pavanës, sarabandës, minuetit etj.</i>- Zhvillimi i baletit në shek. XVII - XVIII. <i>Zhvillimi i baletit në Itali dhe Francë.</i>- Zhan Zhorzh Nover– lufta kundër diletantizmit

	<p>në art dhe Salvatore Vigano.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Romantizmi dhe lulëzimi i baletit klasik. Baleti në shek XIX. Kërcimi poetik. - Zhvillimi i baletit rus – Liqeni i mjellmave etj. - Ana Pavlova – 1910. - Kërcimi në shek. XX- zhvillimi i mëtejshëm i baletit klasik dhe reformat e para moderne. - Zhvillimi i baletit në Shqipëri në shek. XX. <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë me shkrim, se si bashkëpunojnë <i>elementet e kërcimit</i> një lloj kërcimi në një periudhë të caktuar; • të analizojë faktorët që ndikojnë në cilësinë e interpretimit të një kërcimi, individualisht apo në ansamble (p.sh, ritmi, hapësira, dinamika, lëvizjet, etj.); • të diskutojë mbi ndikimin e kërcimeve të ndryshme te vetja dhe në shoqëri, pa paragjykuar mendimet e të tjerëve, p.sh.: ndikimin e kërcimit hip –hop, cha cha cha, valsit etj.; • të marrë pjesë si pjesëmarrës ose organizator në veprimtari të ndryshme artistike në klasë, shkollë, mjedisin ku jeton, në komunitet dhe shoqëri; • të përshkruajë lloje të ndryshme të karrierës në kërcim, duke u mbështetur në llojin dhe nivelin e arsimimit e talentin, kushtet e punës, mundësitë e punësimit, pagën.
--	--

Linja 5: Teknologjia dhe media

Përshkrimi i linjës: Përmes zhvillimit të kësaj linje nxënësit njihen dhe vlerësojnë rolin shumë të madh që ka pasur dhe ka, zhvillimi teknologjik në pasurimin e skenave të kërcimit me mjete të reja, më të përsosura shprehjeje, sidomos në drejtim të *teknikës skenike, fonisë dhe ndriçimit*, por dhe në zhvillimin e makinerisë skenike. Gjithashtu, nxënësit do të studiojnë rolin e medias dhe efektet në lidhje me kërcimin, duke i bërë nxënësit më të ndjeshëm për aftësitë e tyre në këtë fushë.

Orët e sugjeruara: 4

Linja	Objektiva
Teknologjia dhe media	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë bashkëpunimin e kërcimit me gjinitë e tjera të artit si <i>dramaturgjinë, pikturën dekorative</i> dhe kjo e sinkronizuar me muzikën <i>etj.</i>; • të përshkruajë kërcimin si proces i <i>prodhimit dhe i çështjeve të marketingut, të sinkronizuar në lloje të tjera arti si: musical etj.</i>;

	<ul style="list-style-type: none"> • të realizojë përmes një sërë rrugësh <i>promovimin</i> e një performance artistike, duke përdorur <i>fletëpalosjen, reklamën, internetin</i>; • të realizojë një krijim <i>individual dhe kolektiv</i>, bazë për një karrierë të suksesshme.
--	---

4. KËRKESA TË KËRCIMIT NDAJ LËNDËVE TË TJERA

KËRCIMI	FIZIKA
Akustika Tingujt Drita, përthyerja e saj	Nxënës/i, -ja: <ul style="list-style-type: none"> ▪ të përvetësojë ligjet e akustikës, për t'i zbatuar ato gjatë ekzekutimit në situata të ndryshme në skenë. ▪ të përshkruajë formimin e tingullit dhe zhurmës. ▪ të kuptojë formimin e dritës dhe efektet e saj në skenë.
KËRCIMI	HISTORI
Kërcimi në periudhën e shek. XIX	Nxënës/i, -ja: <ul style="list-style-type: none"> ▪ të përshkruajë ngjarjet historike, sociale dhe kulturore që lanë gjurmë në këtë periudhë.
KËRCIMI	EDUKIMI FIZIK DHE SPORTET
Lëvizjet bazë me figura të thjeshta Lëvizjet në vend Pozicionet kryesore	Nxënës/i, -ja: <ul style="list-style-type: none"> ▪ të ekzekutojë përmes lëvizjeve trupore <i>pozicionet kryesore</i>, bazë për kërcimin e një pjese.

5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtarë për lëndën e kërcimit. Dokumentet e tjera kryesore janë: korniza kurrikulare e gjimnazit dhe standardet e fushës kurrikulare të arteve, ku kjo lëndë bën pjesë. Hartimi i programit është mbështetur si te korniza kurrikulare, ashtu edhe te standardet e fushës së arteve.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

Te korniza kurrikulare vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- Synimeve të përgjithshme të kurrikulës së gjimnazit,
- Synimeve të linjave ndërkurrikulare,
- Vlerësimit të nxënësit me notë,
- Parimeve të mësimdhënie-mësimnxënies.

Në mënyrë që tërësia e dokumenteve zyrtarë (korniza kurrikulare, standardet e fushës së të nxënësve dhe programi lëndor) të zbatohen më së miri në dobi të nxënësve, përdoruesit e tyre duhet të njohin thellë programin e lëndës së kërcimit.

Gjithashtu, përdoruesve të këtyre dokumenteve u lind nevoja të njohin standardet e fushës së arteve dhe të të gjitha fushave të tjera të të nxënësve për të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit.

Fusha e arteve vjen për herë të parë në **gjimnaz** në mënyrë të plotë përsa i përket kohës, përmbajtjes dhe strukturës, duke zhvilluar përmbajtjet e katër lëndëve, të cilat janë: muzika, arti pamor, teatri dhe kërcimi. Studimi i dy prej këtyre lëndëve mund të jenë kombinimet: a) *muzikë – kërcim* b) *art pamor – teatër*, apo edhe kombinime të tjera. Fusha e arteve për herë të parë ka një pamje të plotë, duke zhvilluar katër lëndë brenda saj me një përmbajtje të mjaftueshme kulturore për qëllimin që ka shkolla e mesme publike.

Kërcimi **në gjimnaz** vjen për herë të parë si lëndë më vete dhe studiohet në 54 orë mësimore, përkatësisht në 3 semestra me nga 1 orë në javë. Ky program mundëson për herë të parë në gjimnaz, pajisjen e nxënësve me njohuri, aftësi, shprehje dhe vlera. Edhe pse kjo disiplinë arti zhvillohet në një moshë me fizik të formuar (15 vjeç), përmbajtja e tij është i mundur për t'u zhvilluar dhe realizuar nga të gjithë nxënësit që do të përzgjedhin për të ndjekur këtë disiplinë artistike.

Raporti i vëllimit midis njohurive dhe veprimtarive, në lëndën e kërcimit është 50 me 50. Kjo lëndë kërkon aftësimin e nxënësve në kërcim, duke u mësuar atyre teknikat bazë të kërcimit standard, por edhe për t'u aftësuar në kërcime të ndryshme, brenda mundësive fizike të lejueshme sipas moshës dhe gjinisë.

Programi i kërcimit i konceptuar për gjimnazin, do të zgjerojë përvojat e fituara të nxënësve përmes fitimit të aftësive lëvizore në edukimin fizik dhe sportet në arsimin e detyruar, duke zhvilluar më tej aftësitë e tyre krijuese edhe në kërcim.

Programi i kërcimit organizohet sipas linjave të përmbajtjes dhe për çdo linjë shënohen objektivat të cilat materializojnë njohuritë dhe aftësitë mbi kërcimin.

Përzgjedhja e metodave mësimore bëhet nga përdoruesit e këtij programi, për të ndihmuar sa më mirë zhvillimin e procesit mësimor. Kështu mësuesit që do të japin këtë lëndë, do të udhëhiqen nga disa kritere bazë të zhvillimit të kërcimit për këtë grupmoshë, me qëllim realizimin e kërkesave dhe realizimin e këtij programi. Këto kërkesa kanë të bëjnë me njohjen e elementeve të kërcimit si dhe realizimin e tyre në lloje të ndryshme kërcimi. Ato do të jenë:

a) Realizimi i kërkesës së *impotimit të trupit*, i cili është elementi bazë për formimin e një kërcimtari dhe bazë për formimin e të rinjve joprofesionistë në kërcim. Impotimi i trupit do të thotë që të gjithë nxënësit që do të përzgjedhin dhe duan të aftësohen në këtë lëndë, të kenë një qëndrim të ekuilibruar. Për këtë arsye mësuesi duhet të punojë për realizimin e këtij elementi. Një element tjetër i kërcimit që mësuesi duhet të punojë me nxënësit, është edhe *përdorimi i krahëve*, i cili është një nga elementet estetikë në trupin e kërcimtarit, *xhestikulacioni*, *shprehja e fytyrës*, apo përcaktimi i hapësirës së duhur dhe kohës gjatë lëvizjeve në skenë, të cilat janë kërkesa të domosdoshme për përgatitjen e nxënësve në lëndën e kërcimit.

b) Mësues/i,-ja i kërcimit duhet të zhvillojë me nxënësit, kërkesën për realizimin e *shoqërimit muzikor* dhe njohjen e *ritmeve muzikore*, të cilat janë bazë për ekzekutimin e një kërcimi.

c) Përsëritja e vazhdueshme dhe demonstrimi ndaj termave ushtrimore të kërcimit klasik është një nga detyrat kryesore të mësuesve, për të zhvilluar këtë element bazë në të gjitha llojet e kërcimit klasik.

Për zhvillimin e kësaj lënde, një rol të rëndësishëm ka mjedisi ku do të punohet, një studio apo klasë e madhe që do të mundësojë zbatimin me sukses të linjave e programit.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë se që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë çka përshkruhet tek objektivat e përmbajtjes së programit lëndor. Realizimi i objektivave në tema, kapituj, njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

Orët e estetikës, pikërisht në objektivat me përmbajtje të përbashkët, realizohen në mënyrë të përbashkët për të dyja lëndët. Ndërsa objektivat që lidhen specifikuisht me lëndën e zgjedhur do të shpjegohen dhe realizohen nga secila lëndë më vete. Orët e mbledhura për të dyja lëndët e përzgjedhura janë 10 orë, nga të cilat 4 orë janë për kuptimin e përgjithshëm të estetikës në të gjitha artet dhe 6 orët e mbetura do të ndahen sipas specifikave estetike të lëndës së përzgjedhur (3+3).

P.sh.: Objektivi: “Të shpjegojë artet si pjesë e objektit të estetikës” kërkon që të gjithë nxënësit duhet të njohin estetikën si një shkencë që studion edhe artet dhe të përkufizojnë objektin e saj. Nëse një mësues nuk e bën këtë, nuk ka zbatuar programin lëndor.

Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësues/i,-ja dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

P.sh.: Objektivi: “Të zhvillojë *pantomimën* si një gjini e artit teatral, ku përmbajtja jepet nëpërmjet *mimikës*, *gjestit*, *lëvizjes plastike* dhe *pozës*” kërkon që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të njohin dhe realizojnë praktikisht një *pantomimë* në mënyrë të sigurt, por jo për të gjithë do të pretendohet i njëjti nivel i zbatimit të saj.

Një tjetër nivel arritjeje është zbatimi i elementeve të kërcimit për realizimin e pantomimës në një ide më të zhvilluar. Një nivel më i lartë se ky për nxënësin është zbatimi i elementeve të kërcimit për ta realizuar në shkallë më të lartë emocionalisht *pantomimën*, por brenda njohurive të linjës së dhënë. Një nivel edhe më i lartë do të ishte zbatimi dhe ndërthurja e këtyre elementeve të pantomimës në njohuritë e linjave të tjera të kërcimit, pastaj në një situatë të stimuluar nga vetë bota reale.

Orët mësimore

Programi i kërcimit është strukturuar në linja që vijnë njëra pas tjetrës, por nuk do të thotë se mësimdhënia-mësimnxënia duhet të zhvillohet në këtë renditje gjatë vitit shkollor. Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, por janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë.

Domethënë, mësues/i,-ja mund të vendosë të vazhdojë më ngadalë kur vë re se nxënësit hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të linjës, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e lëndës së kërcimit afërsisht **50%** e totalit të orëve mësimore janë për shtjellimin e njohurive dhe aftësive të reja lëndore, ndërsa **50%** e tyre janë për përpunimin e njohurive dhe aftësive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- Përsëritjen brenda një linje të njohurive-bazë të tij (konceptet themelore);
- Integrimin e njohurive të reja të një linje me njohuritë e linjave paraardhëse;
- Integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera brenda fushës së arteve dhe më tej (me fizikën, edukimin fizik, muzikën). (Ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit u duhet kushtuar kohë e posaçme);
- Përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja, lënda duhet parë si një e tërë);
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive dhe të aftësive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- ***Aftësive të posaçme lëndore:***

- krijuese - shkrimin e një ese-je mbi një kërcim të caktuar, duke sjellë një opinion dhe qëndrim personal;

- realizuese - realizimin e një kërcimi (etyd, pantomimë etj.), duke përcjellë emocionet dhe ndjeshmërinë individuale;

- komunikuese – komunikimin e saktë të njohurive mbi kërcimin, ngritja e opinioneve, mendimeve dhe qëndrimeve të tyre rreth artit skenik - koreografik;

- analizuese – analizimin e një kërcimi, përmes elementeve dhe parimeve të kërcimit, nga të cilat përbëhet një vepër dhe që ndihmojnë për të patur një fjalor të saktë artistik gjatë analizës së veprës;

- krahasuese - krahasimin dhe renditjen e karakteristikave të dy veprave koreografike me autorë të ndryshëm që i përkasin së njëjtës periudhë historike.

- ***Formimit të qëndrimeve***, si p.sh: qëndrimi etiko-social etj., dhe gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Një nga kërkesat për zbatimin me sukses të këtij programi është edhe zhvillimi i punës me nxënësit që mund të kenë vështirësi në realizimin e një ushtrimi, etydi, pantomime etj. Mësues/i,-ja i lëndës i del si detyrë kontrolli sistematik i nxënësve që kanë vështirësi, duke u dhënë një ndihmesë përmes demonstrimit të lëvizjeve nga vetë ai/ajo apo që mund të bëhet nga nxënësit e talentuar në mënyrë që të depërtojë njëtrajtshëmrisht me nxënësin që ka mangësi në zhvillimin e lëvizjeve. Një ndihmesë tjetër e madhe për këta nxënës është edhe zhvillimi i një disipline artistike, përgjegjshmërive individuale për të realizuar detyrimet, apo përdorimi i DVD, televizorit etj.

Gjithashtu për nxënësit e talentuar apo që “shkëlqejnë” në performimin e kërcimeve të ndryshme punohet në mënyrë të veçantë. Ata ndoshta jo gjithmonë mund të performojnë me të njëjtën cilësi kërcimet e dhëna, prandaj është detyrë e mësues/i,-t që të evidentojë dhe zhvillojë këto talente, që do të jenë lider të grupit të kërcimit gjatë

veprimtarive të ndryshme artistike të shkollës dhe do të mbajnë peshën kryesore në performancat e tyre.

7. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësve përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësve nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat, programin lëndor dhe mësues/i,-ja nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në programin lëndor.

Objektiv i vlerësimit janë kryesisht mbi aftësitë që do të fitojnë nxënësit gjatë studimit të kësaj lënde. Por ata do të vlerësojnë edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët në grup dhe në veçanti.

Mësues/i,-ja zhvillon vetë duke ndihmuar nxënësit dhe bashkë me nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi p.sh.:

- 1) realizimin më të mirë të një etydi, pantomime etj.;
- 2) përcaktimin e individit më të suksesshëm gjatë debateve për krahasimin e 2 veprave skenike – koreografike, dhënë kjo përmes periudhave, përmbajtjeve, temave, stileve etj.;
- 3) përcaktimin e esesë më të mirë në trajtimin e çështjeve të artit skenik – koreografik, ku sillen opinione apo mendime, argumentohet dhe krijohet një qëndrim personal ndaj çështjes së ngritur;
- 4) dhënien e çmimit shokut/qes për performancën më të mirë në veprimtaritë artistike shkollore dhe komunitet etj.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënës/i, -ja vlerësohet me notë ndërsa demonstroi arritjet në performime të ndryshme, si p.sh: i *motivit dhe lëvizjeve bazë, etydit dhe ushtrimeve përgatitore, pantomimës, monologut* etj.

Në punimet e nxënësve me grupe të vogla, mësues/i,-ja parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Herë pas here mësues/i,-ja duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Nxënësit vlerësohen në praktikë përmes realizimit të një kërcimi. Ato mund të jenë realizime konkrete të performancave të ndryshme të ngarkuara si: *etyd dhe ushtrime përgatitore, pantomimë, monolog* etj., në dobi edhe të veprimtarive të ndryshme shkollore etj.